

## Characteristics of Alice Walker's Womanism



### Cultural Studies

**Keywords:** womanism, feminism, inclusiveness, marginalization, race.

Entela Bilalli

University "Luigj Gurakuqi" of Shkodra, Albania.

### Abstract

Alice Walker's womanism came up as a reaction to the marginalization of colored women in the mainstream of feminist critical theory and politics, which tended to regard the experiences of white, middle-class, Western, and heterosexual women as universal, thus, neglecting and making invisible the intricate realities of non-white women within it. Womanism, thus, developed as an answer to feminism and became a tool for the black women to challenge the policies which marginalized them. It is a term rooted in black folk culture and it supports inclusiveness rather than exclusiveness. Womanism advocated the self-sufficiency and confidence of women and at the same time emphasized the need for a strong bond among women to fight all kinds of oppression. Walker provides an explicit definition of the term. She insists that the womanist appreciates herself, her culture, her womanly attitudes and emotions, her heritage and culture. Womanism celebrates the ideals of black life and encompasses the whole sense of being a woman, especially a black woman. This variety of the meanings clearly shows that the words "womanism" denotes many different things. The aim of this paper is to give a short overview of what womanism is and how it came into existence.

### Hyrje

Në Shtetet e Bashkuara shumë gra jo të bardha të cilat kishin qenë aktive në lëvizjen feministe filluan të vinin në dukje racizmin brenda lëvizjes dhe ndjenin se feminizmi nuk kishte shqetësim të vetin ndërthurjen e racës, klasës, seksualitetit dhe gjinisë duke i bërë gratë jo të bardha që të ndjeheshin të përjashtuara (hooks, 1981; Moraga & Anzaldúa, 1981). Megjithëse feminizmi shpalli si qëllim të vetin luftën kundër diskriminimit seksual dhe emancipimin e të gjitha grave në mbarë botën, ai i dha zë kryesisht nevojave të grave të bardha të shtresës së mesme duke lënë mënjanë përvojat e veçanta të grave zezake. Patrisha Kollins (1990) shprehet se: "Edhe pse gratë intelektuale zezake prej shumë kohësh kanë shprehur një ndërgjegjësim unik feminist përsa i përket ndërlidhjes së racës dhe klasës në strukturimin e gjinisë, historikisht ne [gratë zezake] nuk kemi qenë pjesëmarrëse të plota në organizatat e feministeve të bardha".<sup>274</sup>

Gratë zezake besonin se feminizmi duhej të përfshinte subjektivitete të ndryshme duke sjellë, kështu, në vëmendje edhe çështjet e dallimit racor dhe klasor. Sipas Hudson-Uims, është shenjë e arrogancës dhe dominimit racist të merret si e mirëqenë që përvojat e grave të bardha janë standardi për përvojat e të gjitha grave.<sup>275</sup> Lëvizja feministe e cila drejtohej nga gra të bardha të shtresës së mesme përqëndrohej kryesisht tek shtypja me baza gjinore, por shpërfillte shtypjen raciale dhe klasore sikur gratë zezake të klasës së ulët të mos ekzistonin.<sup>276</sup> Nëse feminizmi nuk ishte në gjendje të përfshinte përvojat e grave zezake, atëherë lindte nevoja për krijimin e një termi të ri më gjithëpërfshirës që të mund të mbarnte këto përvoja. E thënë ndryshe, kishte lindur nevoja për një fjalë të re që të rrokte gjithë kompleksitetin dhe tërësinë e përvojave femërore. Këtë nevojë e plotësoi termi 'grarizëm' (Collins, 1999; Walker, 1983) i Elis Uokerit. Siç shprehet vetë Uokeri:

*Nuk zgjedh grarizmin sepse është më i mirë sesa feminizmi ... e zgjedh sepse më pëlqen tingulli, ndjesia, përshtatja; sepse unë dua shumë shpirtin e grave (si Soxhërnër) që kjo fjalë sjell ndër mend, sepse unë kam zakonin e vjetër etnik amerikan të të ofruarit të një fjale të re për shoqërinë kur fjala e vjetër që ajo përdor nuk arrin që të përshkruajë siç duhet sjelljen dhe ndryshimin e kësaj shoqërie që vetëm një fjalë e re mund të ndihmojë që ta kuptojë.*<sup>277</sup>

<sup>274</sup> Patricia Hill Collins. *Black Feminist Thought: Knowledge, Consciousness and the Politics of Empowerment*. New York: Routledge, 1991.

<sup>275</sup> Hudson-Weems, Clenora. *Africana Womanist: Reclaiming Ourselves*, 2nd rev. ed. Troy: Bedford: 1994. p. 209.

<sup>276</sup> bell hooks. 'Black Feminism: Historical Perspective' in *Call and Response: The Riverside Anthology of African American Literary Tradition*. Liggings Hills et al. (eds). Boston: Houghton Miffling Company 1998.1. 844.

<sup>277</sup> Alice Walker. *In Search of Our Mothers' Gardens: Womanist Prose*. San Diego: Harcourt Brace Jovanovich, 1983. p.94.

## Çfarë është grarizmi dhe ku ndryshon nga feminizmi?

Grarizmi mund të përkufizohet si një perspektivë epistemologjike e bazuar në përvojat kolektive të grave zezake dhe grave jo të bardha. “Grarizmi përmbledhë çështje raciale, kulturore, seksuale, kombëtare, ekonomike dhe politike”.<sup>278</sup> Filips përpiqet të na japë një përkufizim të vetëm të grarizmit si: një perspektivë e ndryshimeve sociale që i ka rrënjët në përvojat e përditshme të grave zezake dhe grave të tjera [jo të bardha] dhe në metodat e përditshme të zgjidhjes së problemeve ku përfshihet zhdukja e çdo lloj forme shtypjeje për të gjithë njerëzit, rikthimi i ekuilibrit midis njerëzve dhe mjedisit/natyrës dhe harmonizimi i jetës njerëzore me dimensionin shpirtëror. Pra, grarizmi nuk privilegjon njërin gjini apo seks, por i sheh si një lloj të dëmshme të gjitha format e shtypjes e diskriminimit.<sup>279</sup>

Së pari, graristet janë kundër shtypjes sepse ata kritikojnë lloje të ndryshme të diskriminimit. Për rrjedhojë, ata janë kundër racizmit, kundër seksizmit dhe kundër homofobisë. Grarizmi dallon nga feminizmi sepse pranon shtypjen e trefishtë të grave zezake dhe diskriminimi racor, klasor dhe gjinor identifikohen dhe luftohen nga grarizmi ndryshe nga feminizmi që ka si shqetësim kryesor vetëm luftën kundër diskriminimit gjinor. Grarizmi përpiqet të ngrihet mbi marrëdhëniet e dominimit dhe shtypjes, të kapërcejë kufijtë e këtyre marrëdhënieve duke zbehur të gjitha vijat ndarëse që i kategorizojnë njerëzit.

Së dyti, grarizmi nxit përdorimin e traditës gojore si mjet për t’u përballur me realitetin e përditshëm të bashkësisë në mënyrë që të tërheqë njerëz që kanë shqetësime të përbashkëta si dhe kujdesin ndaj: dashurisë, shëndetit, strehimit, ushqimit, jetës dhe vdekjes. Gjithashtu, grarizmi i ka rrënjët në kulturën afro-amerikane e cila është përgjegjëse për vendin kryesor që zë familja, bashkësia dhe mëmësia në ligjërimin e saj.

Së treti, grarizmi i vë një theks të veçantë bashkësisë si grup që është zgjeruar në shumë nivele duke filluar me gratë zezake, ato me ngjyrë e duke vazhduar me të gjitha bashkësitë të cilat vuajnë nga shtypja e duke përfshirë të gjithë njerëzimin në tërësi. Pra, grarizmi nuk ka si shqetësim të vetëm gratë zezake, por qëllimet e përbashkëta të të gjithë njerëzve.

Sipas Filips, elementi i katërt që karakterizon grarizmin është dimensionin shpirtëror që shkrin gjërat e rëndomta të së përditshmes me ato shpirtërore. Ky aspekt i grarizmit gjen shprehje në aktivizimin shoqëror të bazuar në besimet shpirtërore. Kjo është ndoshta edhe karakteristika më origjinale dhe më e debatueshme e grarizmit. Në lidhje me këtë, Lajli Filips përcaktoi një numër metodash të cilat graristet i përdorin me efikasitet për të arritur ndryshime shoqërore si: dialogu, meditimi, aktiviteti shpirtëror, harmonia, ekuilibri dhe paqja.

Një tjetër karakteristikë që e dallon grarizmin nga feminizmi është qëndrimi ndaj burrave. Ndryshe nga feministet e bardha që përqëndrohen vetëm tek gratë, graristet janë të interesuara për mirëqenien e burrave dhe grave. Graristet besojnë në bashkëpunimin me burrat. Kjo karakteristikë e dallon grarizmin nga feminizmi i cili është kryesisht një ideologji e ndasisë.<sup>280</sup> Grarizmi e bën të qartë që përvojat e grave zezake janë të ndryshme nga ato të grave të bardha dhe duke pranuar bashkëpunimin e burrave në përpjekjen për emancipim ndryshon përsëri nga feminizmi i cili i përjashton burrat nga kjo përpjekje.

<sup>278</sup> E.B. Brown. (1989). *Womanist Consciousness: Maggie Lena Walker and the Independent Order of Saint Luke*, *Signs*, 14, 613.

<sup>279</sup> Layli Phillips. (Ed). (2006). *The Womanist Reader*. New York: Taylor & Francis.p. xx.

<sup>280</sup> bell hooks. ‘Black Feminism: Historical Perspective’ in *Call and Response: The Riverside Anthology of African American Literary Tradition*. Liggins Hills et al. (eds). Boston: Houghton Miffling Company 1998. 1,845.

## Karakteristikat e grarizmit

Krijimi i termit grarizëm dhe kuptimet e shumta që Uokeri përçon përmes tij ishin një përpjekje për një pozicionim të saktë të grave zezake në histori dhe kulturë dhe në të njëjtën kohë përpjekje për t'i shpëtuar ata nga stereotipet e pasakta dhe negative që iu ishin mveshur tradicionalisht. Uokeri e ka përkufizuar disa herë termin dhe çdo herë përkufizimi është më i plotë, më i pasur e më i thellë. Uokeri e përkufizon termin me fjalët: 'feminist, afro-centrik, shërues, i mishëruar dhe shpirtëror'.<sup>281</sup> Sipas Elis Uokerit:<sup>282</sup>

1. Grariste: Nga "grarisht" (ndryshe nga "si vajzuke" që domethënë e papërgjegjshme, jo serioze.) Një feministe zezake ose me ngjyrë. Nga shprehja bisedore që nënat u thonë vajzave "Po sillesh grarisht. Zakonisht i referohet sjelljes fyese, të pacipë, të guximshme ose kokëfortë. Dëshirës për të ditur më shumë dhe më me thellësi sesa ç'mund të konsiderohet "e mirë" për dikë. Interesimit për të ditur gjërat e të rriturve. Sjelljes prej të rrituri. Të qenit e rritur. E ndër këmbëveshme me shprehje të tjera bisedore si: "po përpiqesh të jesh e rritur. E përgjegjshme. Komanduese. *Serioze...*

2. Gjithashtu: Një grua që do gratë e tjera, seksualisht dhe/ose jo seksualisht. Vlerëson dhe preferon kulturën e grave, fleksibilitetin emocional të grave (vlerëson lotët si kundërpeshë e të qeshurës) dhe forcën e grave. Nganjëherë dashuron burrat seksualisht dhe/ose jo seksualisht. E përkushtuar ndaj mbijetesës dhe plotësisë së tërë njerëzve, femra dhe meshkuj. Jo separatiste, përveçse me raste për shëndet. Tradicionalisht universaliste, si në rastin e: "Mami pse jemi bojëkafë, rozë dhe të verdhë dhe kushërinjtë tanë janë të bardhë, bezhë dhe të zinj?". Përgjigja: "Epo, e di se raca me ngjyrë është si një kopësht me lule me çdo lule të përfaqësuar". Tradicionalisht e aftë, si në rastin e: "Mami do shkoj në Kanada dhe do të të marr ty dhe një tufë skllëvërish të tjerë me vete". Përgjigja: "Nuk do ishte hera e parë".

3. Do muzikën. Do kërcimin. Do hënën. Do shpirtin. Do dashurinë, ushqimin dhe rrumbullakësinë. Do njerëzit. Do veten. Gjithsesi.

4. Grarishtja është ndaj feminizmit si e purpurta ndaj ciklaminit.

Është e qartë nga këto katër përkufizime që grarizmi himnizon rrënjët zezake, aspiratat e zezakëve dhe paraqet një pamje të balancuar të grarisë zezake. Termi ka konotacione specifike që e lidhin me bashkësinë femërore afro-amerikane. Eliot Batler-Evans vëren se këto përkufizime mund të përdoren si një kornizë për të interpretuar veprat e shkrimtareve zezake. Shtresat kuptimore të grarizmit janë në përputhje të plotë me qëndrimin e Uokerit kur ajo refuzon të përqafojë një ideologji që është e ngushtë dhe jo në harmoni me shpirtëroren. Këto shtresa kuptimore pasqyrojnë theksin që vë Uokeri tek ekuilibri, forca e të cilit e bën estetikën e saj grariste të spikatur dhe shëruese. Ka ekuilibër në mendimet e saj dhe në artin e saj: ekuilibër midis realitetit të grave dhe shqetësimit për universin e gjerë me të cilin gratë zezake, ashtu si të gjithë njerëzit, janë të lidhura.

Elementi i parë i termit ka të bëjë me etimologjinë e tij. Uokeri e përcakton grarizmin si sinonim i feminizmit zezak, ose me ngjyrë. Duke shtuar elementin përfshirës 'me ngjyrë', Uokeri shmang diskriminimin për të cilin është kritikuar feminizmi. Ajo i shton një element etnik dhe nacionalist elementit gjinor që përmban termi "feministe". Termi 'grarizëm'/'grarist' rrjedh nga mbiemri i përdorur në të folmen zezake 'womanish'- 'grarisht' përdorur kryesisht në fjalinë "Po sillesh grarisht"<sup>283</sup> të cilën nënat ia thonë vajzave dhe e cila ka të

<sup>281</sup> Arisika Razak. "Response." *Journal of Feminist Studies in Religion* 22.1 (2006): 100.

<sup>282</sup> Alice Walker. *In Search of Our Mothers' Gardens: Womanist Prose*. San Diego: Harcourt Brace Jovanovich, 1983. p. xi-xii.

<sup>283</sup> You acting womanish.

njëjtin kuptim si shprehja tjetër e të folmes zezake “Po përpiqesh të bësh si e rritur”.<sup>284</sup> Siç vë në dukje Kolins, duke "e marrë termin nga e folmja zezake e nënave me fëmijët e tyre vajza [...], Uokeri sugjeron që historia e grave zezake ushqen një pikëpamje grariste e cila është e arritshme dhe e lejueshme kryesisht ose tërësisht vetëm për gratë zezake”.<sup>285</sup>

Pjesa e parë e përkufizimit thekson pjekurinë. “Po sillesh grarisht” dhe “Po përpiqesh të bësh si e rritur” tregojnë sjellje guximtare, kurajoze, dhe të vullnetshme” dhe i referohen të thënit e të bërit të diçkaje e cila nuk është e thjeshtë, por e bërë me shumë vendosmëri dhe motivim. Siç vëren Saunders: “Theksi vihet tek sjellja e guximshme dhe vendosmëria, sepse për shumë kohë grave zezake u është mohuar e drejta për të vendosur me vullnet të lirë dhe për këtë, një pjesë të fajit e kanë edhe burrat zezakë”.<sup>286</sup>

Në të gjitha veprat e shkrimtareve afro-amerikane lidhjet femërore janë burim force dhe mbështetjeje. Uokeri e përkufizon graristen duke iu referuar llojit të lidhjeve që krijohen mes grave. Gرارistet duan gratë e tjera, sidomos për gjërat që i bëjnë të ndihen gra, si jeta emocionale e forca shpirtërore. Pra, grارistet duan edhe atë që është femërore tek gratë e tjera dhe tek ata vetë. Uokeri, pra, nuk përjashton as lidhjet heteroseksuale dhe as ato lezbike. Kjo ndoshta përbën dallimin më të dukshëm midis grarizmit dhe feminizmit të bardhë. “Dashuria seksuale dhe jo seksuale për burrat” është një nga karakteristikat e grarizmit.

Uokeri nxjerr në pah qëndrimin unik të grarizmit ndaj diskriminimit të trefishtë të grave. Duke i dashur të gjithë njerëzit, grارistja është e shqetësuar për mbijetesën dhe plotësinë e të gjithë njerëzve, femra e meshkuj. Ky përkushtim ndaj mirëqënies së të gjithë njerëzve pasqyron shqetësimet globale të grarizmit. Teologia grariste Zhaklin Grant shprehet se: “Të flasësh për realitetin tredimensional të grave zezake ... do të thotë të mos flasësh vetëm për gratë zezake, sepse ka një universalitet të nënkuptuar që i lidh ata me të tjerët”.<sup>287</sup>

Edhe pse preferon pikëvështrimin femëror të botës dhe “do gratë”, grarizmi do edhe burrat, por refuzon vlerat mashkullore tek ata. Ky është një ndryshim i madh nga feminizmi i cili, me të drejtë apo jo, nënkupton një refuzim të meshkujve në vetvete. Edhe pse burrat të cilët Uokeri citon janë ato me lidhje gjaku – “baballarët, vëllezërit, djemtë” – duhet të kemi parasysh që këto terma në kulturën zezake përdoren njëllor edhe për persona të cilët nuk kanë lidhje gjaku.

Kjo ide duket se përsëritet edhe tek shprehja “lidhshmëri me të gjithë bashkësinë dhe botën”. Fakti që Uokeri ia mvesh kulturës zezake dhe jo grave zezake këtë dashuri për të gjitha qëniet njerëzore sugjeron se këto vlera janë të përbashkëta për të shtypurit e shoqërisë (gratë dhe zezakët) dhe u janë dhënë atyre nga shtypësit (meshkujt e bardhë). Gjithashtu, grarizmi ka të bëjë me plotësinë e individit në këtë bashkësi përkundrejt fragmentarizimit që është karakteristik për përvojat afro-amerikane. Siç shprehet vetë Uokeri, ajo është “e shqetësuar për mbijetesën shpirtërore, mbijetesën e *plotë* të të gjithë njerëzve”.

Mbi të gjitha ky përkufizim i dashurisë grariste thekson rezistencën ndaj praktikave patriarkale perëndimore. Ai bën thirrje për njohjen e bukurisë femërore dhe për rritjen e vetëvlerësimit të grave. Duke qenë vetë e fuqizuar, një grariste kërkon të fuqizojë të tjerët, femra e meshkuj, sepse ajo pranon barazinë e të gjithë njerëzve ndryshe nga strukturat mbizotëruese patriarkale që i caktojnë gruas një status inferior. Në vend të

<sup>284</sup>You trying to be grown.

<sup>285</sup> Patricia Hill Collins. “What’s in a name? Womanism, Black Feminism, and Beyond.” *Black Scholar* 26.1 (1996):10.

<sup>286</sup> James Robert Saunders. “Womanism as the Key to Understanding Zora Neale Hurston’s *Their Eyes Were Watching God* and Alice Walker’s *The Color Purple*.” *The Hollins Critic* 25.4 (1988): 11.

<sup>287</sup> Jacquelyn Grant. *White Women’s Christ and Black Women’s Jesus: Feminist Christology and Womanist Response* (Atlanta: Scholars Press, 1989), p. 217.

veprimeve hakmarrëse ndaj meshkujve për dominimin e tyre historik, graristja e kapërcen urrejtjen me mirësi e dashuri dhe vë në dukje veçantinë e secilës shprehje e përvojë individuale. Ky është në vetvete një refuzim për t'i kategorizuar njerëzit në superior e inferior. Në këtë aspekt, dashuria grariste kundërshton idealet patriarkale të cilat i shtypin gratë për shkak të gjinisë dhe të njëjtin qëndrim mbajnë edhe ndaj strukturave sociale, sistemeve të besimit dhe estetikës jo perëndimore. Përveç kësaj, Uokeri shprehet se është "e përkushtuar ndaj analizës së shtypjes, çmendurive, besnikërive dhe triumfeve të grave zezake".<sup>288</sup> Ajo e vazhdon përkufizimin e graristes duke thënë se 'graristja e do veten. Gjithsesi'.<sup>289</sup> Pra, Uokeri thekson se graristja e vlerëson veten, kulturën e saj, sjelljet dhe emocionet e saj prej gruaje, edhe përballë një shoqërie e cila këmbëngul që lotët, emocionet, kompromisi, subjektiviteti dhe tipare të tjera "femërore" janë shenja dobësie dhe të një natyre inferiore krahasuar me cilësitë "meshkullore" të kontrollit të emocioneve, dominimit dhe objektivitetit. Cilësi të tilla tek një grua jo vetëm që nuk janë inferiore, por përkundrazi janë thelbësore për mirëqënien e individit dhe për t'u ndjerë mirë me veten dhe me botën.

Uokeri e mbyll përkufizimin e saj me një tjetër polemikë apo kundërvënie të feminizmit me grarizmin: "Grarizmi është ndaj feminizmit si e purpurta ndaj ciklaminit", që do të thotë se jo vetëm që përfshin gjithçka të nënkuptuar tek feminizmi, por është edhe më i thellë, më i pasur, më prekës. Zgjedhjen seksuale Uokeri, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, e lë si të tillë - një zgjedhje - duke pranuar se dashuria seksuale është një shprehje e jashtme fizike e një ndjenje të brendshme "lidhshmërie" dhe dashurie<sup>290</sup> pavarësisht nga gjinia e personit. Në këtë vlerësim të njerëzve për atë që janë pavarësisht gjinisë, racës apo klasës, Uokeri ri-pohon universalizmin e saj dhe duhet theksuar se ngjyra e bardhë nuk është e përjashtuar nga 'kopështi' i Uokerit, që do të thotë se lidhshmëria me të gjitha qëniet njerëzore përfshin edhe ata që historikisht i kanë shtypur zezakët. Në lidhje me këtë Uokeri shkruan duke theksuar se "nuk janë vetëm indigenët ata të cilët mund të na ofrojnë ne gjëra të mira me të cilat të mund të formojmë të ardhmen. Ne duhet të *pranojmë*, të *përdorim* dhe të *duam* atë që është e mirë nga të gjithë ne. Çdo popull. Çdo gjini. Çdo racë. Madje çdo moshë ...".<sup>291</sup> Grarizmi ka të bëjë me "përkushtimin ndaj mbijetesës dhe plotësisë së tërë njerëzve, femrave dhe meshkujve"<sup>292</sup> pra, me të tërë bashkësinë, duke përfshirë të gjithë anëtarët e saj pavarësisht gjinisë.

### Receptimi i grarizmit si koncept

Grarizmi i Elis Uokerit ka ngjallur debate të shumta. Shumë nga këto debate kanë të bëjnë me dallimet dhe tensionin midis grarizmit dhe feminizmit zezak. Tuziline Xhita Alan e sheh grarizmin si një koncept esencialist sepse "i përket feministeve zezake dhe feministeve me ngjyrë dhe për pasojë i përjashton gratë e bardha".<sup>293</sup> Patrisha Hill Kollins ofron një kritikë të të dyjave. Ajo vëren se "debatet nëse duhet të emërtohet qëndrimi i grave zeake si grarist apo feminist, tregojnë për dallimet që ekzistojnë midis grave zezake. Sipas saj, përkufizimi i Uokerit bën thirrje për tre filozofi të rëndësishme, por kontradiktore të cilat nxisin nacionalizmin zezak përmes pretendimeve për superioritet moral e epistemologjik të grave zezake; forcën përmes vuajtjes nga diskriminimi racor e gjinor; shumësinë përmes integritetit kulturor i dhënë me metaforën e kopështit; integrimin/asimilimin përmes pretendimeve se gratë zezake janë tradicionalisht universaliste".<sup>294</sup> Duke ndërthurur ndasinë me superioritetin moral zezak të filozofisë nacionaliste zezake, pluralizmin e fuqizimit zezak dhe kritikën e feminizmit, grarizmi përpiqet t'u japë një zë grave zezake, por nuk merr në konsideratë siç duhet heterogjenitetin e grave me prejardhje afrikane dhe historitë dhe realitetet e tyre të ndryshme. Pavarësisht

<sup>288</sup> John O'Brien. "Alice Walker: An Interview," in *Alice Walker: Critical Perspectives Past and Present*, eds. Henry Louis Gates, Jr. & K.A. Appiah (New York: Amistad, 1993), p. 331.

<sup>289</sup> Alice Walker. *In Search of Our Mothers' Gardens: Womanist Prose*. San Diego: Harcourt Brace Jovanovich, 1983. p. xii.

<sup>290</sup> Shih, për shembull, Marge Piercy, "The turn-on of Intimacy", *Ms.*, vol.XII, num.8, February, 1984, p.46-48.

<sup>291</sup> "Alice Walker: Enduring in the face of Everything", *Good Housekeeping*, vol. 127, num. 6, June, 1985, p. 227.

<sup>292</sup> Alice Walker. *In Search of Our Mothers' Gardens: Womanist Prose*. San Diego: Harcourt Brace Jovanovich, 1983. xi.

<sup>293</sup> *Ibid.*, p. 61.

<sup>294</sup> Patricia Hill Collins. "What's in a Name? Womanism, Black Feminism, and Beyond." *The Black Scholar* 26, no.1 (1996): 11.

debateve, grarizmi si koncept ka pasur ndikim të madh në formulimin e teorive dhe kornizave analitike në fushën e studimeve gjinore, letrare, fetare, etj. Në vitin 1993 fjala ‘grarizëm’ dhe kuptimet që Uokeri i mveshi asaj u fut në *Fjalorin Amerikan të Trashëgimisë (American Heritage Dictionary)* i cili jep këtë përkufizim: “të pasurit apo të shprehurit e besimit tek gratë dhe respektit për gratë dhe talentet e aftësitë e tyre përtej kufijve të racës dhe klasës”.<sup>295</sup> Ndikimi i grarizmit shkon përtej kufijve të Shteteve të Bashkuara, në Afrikë, ku shumë studiuese dhe kritike letrare e përdorin atë si një mjet analitik në studimet e tyre.

## Përfundime

Sot, kur më shumë se një çerek shekulli ka kaluar nga publikimi i përmbledhjes “*Në kërkim të kopështit të nënave tonë*”, mungon një trajtim sistematik i idesë grariste dhe mungon, gjithashtu, një përmbledhje studimesh grariste të cilat të mund të dokumentojnë se çfarë ka ndodhur gjatë kësaj periudhe me grarizmin dhe krijimtarinë grariste. Gjithsesi, grarizmi i Uokerit është shumë më tepër se një përpjekje për të përfshirë gratë zezake në lëvizjen për të drejtat e grave, është besimi në potencialin njerëzor që ka fuqinë të pasurojë jetën e gjithësecilit.

## Referencat

1. Brewer, Kristeva. “Writing to Survive: An Interview with Alice Walker”, *Southern Exposure: Festival*, vol. IX, num. 2, Summer, 1981.
2. Brown, E.B. (1989). “Womanist Consciousness: Maggie Lena Walker and the Independent Order of Saint Luke”, *Signs*, 14, 613.
3. Collins, Patricia Hill. “What's in a Name? Womanism, Black Feminism, and Beyond.” *The Black Scholar* 26, no.1.1996.
4. Gjipali, S. dhe Ruci, L. (1994) Gratë shqipëtare: Hezitime dhe Perspektiva. *Fitore dhe Humbje: Gratë dhe tranzicioni në Europën Lindore dhe Qëndrore*, Bukuresht.
5. Grant, Jacquelyn. White Women’s Christ And Black Women’s Jesus: Feminist Christology and Womanist Response (Atlanta: Scholars Press, 1989).
6. Hooks, bell. ‘Black Feminism: Historical Perspective’ in *Call and Response: The Riverside Anthology of African American Literary Tradition*. Liggins Hills et al. (eds). Boston: Houghton Miffling Company 1998.1.
7. Hudson-Weems, Clenora. *Africana Womanist: Reclaiming Ourselves*, 2nd rev. ed. Troy: Bedford: 1994.
8. Kligman, G. (1996) *Gratë dhe negocijimi i identitetit në Europën Lindore post-komuniste* In V. Bonnel (ed.) *Identitete në tranzicion: Europa Lindore dhe Russia Pas rëzimit të Komunizmit*. Studime Ndërkombëtare dhe të Rajonit: Berkeley, CA.
9. O’Brien, John. “Alice Walker: An Interview,” in Alice Walker: *Critical Perspectives Past and Present*, eds. Henry Louis Gates, Jr. & K.A. Appiah. New York: Amistad, 1993.
10. Phillips, Layli. *The Womanist Reader*. New York and London: Routledge, 2006.
11. Razak, Arisika. Razak, Arisika. “Response.” *Journal of Feminist Studies in Religion* 22.1. 2006.
12. Riggs, Marcia Y. *Awake, Arise, and Act: A Womanist Call for Black Liberation*. Cleveland, Ohio: Pilgrim Press, 1994
13. Saunders, James Robert. “Womanism as the Key to Understanding Zora Neale Hurston’s *Their Eyes Were Watching God* and Alice Walker’s *The Color Purple*.” *The Hollins Critic* 25.4 (1988).
14. Walker, Alice. Enduring in the face of Everything”, *Good Housekeeping*, vol. 127, num. 6, June, 1985.
15. Walker, Alice. *In Search of Our Mothers’ Gardens: Womanist Prose*. San Diego: Harcourt Brace Jovanovich, 1983.

<sup>295</sup> *American Heritage Dictionary*: <http://www.answers.com/topic/womanism?method=5&linktext=womanist>.